



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:238875
Datë: 04.06.2024
Numri i dokumentit: 05778084

C.nr.977/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Betim Behluli, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve: K.M nga fshati Zoqishtë, Komuna e Rahovecit, L.G nga fshati Studenqan, Komuna e Suharekes, M.Q dhe M.D që të dy nga fshati Zoqishtë, Komuna e Rahovecit dhe N.S nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson D.M, avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Rahovec, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 3.613,01 euro, jashtë seance, më datën 04.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve: K.M, L.G, M.Q, M.D dhe N.S.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit K.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Nëntor – Dhjetor 2020 në shumën prej 1.008 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 102.81 euro, si dhe për periudhën kohore Janar – Tetor 2022 në shumën prej 292.32 euro, në shumën e përgjithshme prej 396.13 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.11.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses L.G, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Nëntor – Dhjetor 2020 në shumën prej 1.57 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 160.34 euro, si dhe për periudhën kohore Janar – Tetor 2022 në shumën prej 455.88 euro, në shumën e përgjithshme prej 617.79 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.11.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit M.Q, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Nëntor – Dhjetor 2020 në shumën prej 1.68 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar – Tetor 2022 në shumën prej 488.36 euro, në shumën e përgjithshme prej 661.8 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.11.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit M.D, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Nëntor – Dhjetor 2020 në shumën prej 1.008 euro, për periudhën kohore

Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 102.81 euro, si dhe për periudhën kohore Janar – Tetor 2022 në shumën prej 292.32 euro, në shumën e përgjithshme prej 396.13 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.11.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit N.S, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Nëntor – Dhjetor 2020 në shumën prej 1.68 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar – Tetor 2022 në shumën prej 488.36 euro, në shumën e përgjithshme prej 661.8 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.11.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

VII. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit K.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 396.13 euro e deri në shumën 722.62 euro, dhe atë në shumën prej 326.48 euro.

VIII. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses L.G, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 617.79 euro e deri në shumën 722.62 euro, dhe atë në shumën prej 104.83 euro.

IX. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit M.Q, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 661.8 euro e deri në shumën 722.62 euro, dhe atë në shumën prej 60.82 euro.

X. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit M.D, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 396.13 euro e deri në shumën 722.62 euro, dhe atë në shumën prej 326.48 euro.

XI. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit N.S, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 661.8 euro e deri në shumën 722.62 euro, dhe atë në shumën prej 60.82 euro.

XII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve: K.M, L.G, M.Q, M.D dhe N.S, ti paguaj shumën prej 352.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit: K.M nga fshati Zoqishtë, Komuna e Rahovecit, L.G nga fshati Studenqan, Komuna e Suharekës, M.Q nga Fshati Zoqishtë, Komuna e Rahovecit, M.D nga fshati Zoqishtë, Komuna e Rahovecit dhe N.S nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë me datë 06.11.2023, përmes të autorizuarit të tyre D.M, avokat në Prizren, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të nenit 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe 22.01.2022 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhet të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërsi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 14.03.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën është thirrur pala paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Kërkesëpadinë e paditësve e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Paditësit kanë parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 06.11.2023, andaj konsideron që kërkesëpadia e paditësve është parashtruar në tërësi ngase nga hyrja në fuqi e KKAK, të datës 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në këtë gjykatë kanë kaluar më shumë se 3 vite. Paditësit nuk i kanë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësve pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësit të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën SH.F.M.U “Haki Stërmilli”, në fshatin Zoqishtë, Komuna e Rahovecit. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2022 vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësve është në shumën prej 393 euro për paditësen L.G, 421 euro për paditësin M.Q dhe N.S, 252 euro për paditësin K.M dhe M.D. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës

së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve: K.M, L.G, M.Q, M.D dhe N.S, i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (datë e parashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 12.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë në pjesën tjetër në shumën prej 104.83 euro për paditësen L.G, shumën prej 60.88 euro për paditësit M.Q dhe N.S, si dhe shumën prej 326.48 euro për paditësit K.M dhe M.D, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësja L.G, përfitonë ngritje në bazë të pagës bazë (393) euro, paditësit M.Q dhe N.S, përfitonë ngritje në bazë të pagës bazë (421) euro, ndërsa paditësit K.M dhe M.D, përfitojnë ngritje në bazë të pagës bazë (252) euro dhe jo në bazë të pagës mujore të paditësve. Gjykata vlerëson se baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa për periudhën kohore janar-nëntor 2020, është e parashkuar.

Po ashtu Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar pjesën e kërkesëpadisë si më lartë, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësit gjatë vitit 2022, përfitojnë ngritje në bazë të inflacionit për dhjetë (10) muaj, e jo për dymbëdhjetë (12) muaj, siç kanë kërkuar në padi, edhe pse më datën 22.01.2021 është lidhur Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, njëra palë kontraktuese më datën 22.11.2022 është tërhequr nga zbatimi i kësaj Kontrate Kolektive. Në këtë Kontratë Kolektive kanë qenë të parapara edhe hapat e kontestimit të shkëputjes së kësaj Kontrate, mirëpo nga pala tjetër nënshkruese nuk janë paraqitur prova me të cilën do ta dëshmonin se është kontestuar vlefshmëria e Kontratës Kolektive. Këtë qëndrim e mban edhe Gjykata Supreme e Kosovës, e cila në mendimin e saj juridik me numër 214/2023 të datës 05.10.2023, ka theksuar se *“Në rrethana të tilla, kjo gjykatë vlerëson se rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga kjo kontratë duhet trajtuar sipas kësaj kontrate dhe atë deri me datën 21.11.2022, kur është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese, marrë për bazë arsyet e paraqitura më lartë”*.

Sa i përket pjesës refuzuese gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjykata për këtë çështje ka vlerësuar se si moment/periudhë e rrjedhës së kamatës për kërkesat regresuese të kreditorit, duhet të merret data e parashtrimit të kërkesës së kreditorit tek debitori (data e pranimit të kërkesës nga ana e debitorit), apo data e parashtrimit të padisë në gjykatë për rastet kur kreditori nuk ka paraqitur paraprakisht një kërkesë të tillë tek debitori. LMD me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 ka përcaktuar detyrimin e pagesës së kamatëvonesës: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen është përcaktuar se: *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*. Në rastin konkret, duke qenë se debitori vetëm në momentin e pranimit të padisë nga gjykata është njohur me përmbajtjen e detyrimit për pagesën e kërkesës regresuese të kreditorit, gjykata si moment të rrjedhjes së kamatës së kreditorit ka marrë datën 06.11.2023, kur është parashtruar padia dhe mbi këtë bazë ka refuzuar shumën prej 57.51 euro, si shumë e kamatës vjetore, e cila ishte paraqitur bashkë me kërkesën kryesore si vlerë e përgjithshme.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është

përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 40 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 352.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.977/23, më datën 04.06.2024

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.